



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0073356-2/21 dt. 13.11.2024
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020 si dhe Propozim – Vendimin Nr. 01-020/04-0073356/24, dt. 11.11.2024, të Drejtorisë për Shëndetësi, Kryetari i Komunës, sjell këtë:

V E N D I M

(Për Formimin e Grupit Punues për Hartimin e Planit Zhvillimor Institucional të Kujdesit Parësor Shëndetësor 2025 – 2029)

1. **Formohet** Grupi Punues për Hartimin e Planit Zhvillimor Institucional të Kujdesit Parësor Shëndetësor 2025 – 2029, në këtë përbërje:
 - 1.1. Fahri Shabani – kryetar, (Drejtor i DSH-së);
 - 1.2. Fevzi Sylejmani – anëtar, (Drejtor i QKMF-së);
 - 1.3. Mehmet Uka – anëtar, (QKMF);
 - 1.4. Berat Jashari – anëtar, (DSH);
 - 1.5. Arbenita Mustafa Januzi – anëtare, (DSH);
 - 1.6. Albana Fejza – anëtare, (DSH);
 - 1.7. Shukrije Baruti – anëtare, (QKMF);
 - 1.8. Alketa Shaqiri – anëtare, (QKMF);
 - 1.9. Diedona Musa Pllana – anëtare, (QKMF);
 - 1.10. Minire Zasella – anëtare, (QKMF);
 - 1.11. Meleqe Morina – anëtare, (QKMF);
 - 1.12. Emrika Uka – anëtare, (QKMF);
 - 1.13. Jehona Leci Ymeri – anëtare, (QKMF);
 - 1.14. Halide Istrefi – anëtare, (QKMF);
 - 1.15. Hamdi Shyti – anëtar, (Këshilli i Pacientëve).
2. Grupi Punues i lartcekur obligohet të bëj Hartimin e Draft – Planin Zhvillimor Institucional të Kujdesit Parësor Shëndetësor 2025 – 2029.
3. Grupi Punues do ta hartojë raportin përfundimtar, në bazë të cilit do të krijohet dokumenti kryesor; Planin Zhvillimor Institucional të Kujdesit Parësor Shëndetësor 2025 – 2029.

Handwritten signature

4. Grupi punues, përmes hartimit të Planit Zhvillimor Institucional të Kujdesit Parësor Shëndetësor 2025 – 2029, do të përcaktoj qëllimet themelore dhe drejtimet e zhvillimit të sistemit Parësor Shëndetësor të Komunës së Mitrovicës së Jugut për këtë periudhë kohore.
5. Grupi Punues, fokus në punën e tij do të ketë përcaktimin e objektivave strategjike si dhe prioritetet kryesore që do të lidhen me fushat për menaxhimin e Shërbimeve të Kujdesit Parësor Shëndetësor në Komunën e Mitrovicës së Jugut.
6. Grupi Punues, bazë për punën e tij do të ketë; Qasjen gjithëpërfshirëse si dhe Planifikimin e bazuar në evidencë, përfshirë nevojat e komunitetit.
7. Grupi Punues i formuar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi bazë për punën e tij do të ketë Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Statutin e Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Rregulloren (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, Udhëzimin Administrativ (Shëndetësi) Nr. 08/2017 Organizimi, Struktura, Përcaktimi i Shërbimeve dhe Veprimtarisë së Institucioneve të Kujdesit Parësorë Shëndetësor (KPSH), Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017-2021 (MSH 2016) si dhe aktet ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.
8. Mandati i Grupit Punues të formuar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi, përfundon me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuar me këtë Vendim.
9. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës

Bedri HAMZA

Shtojcë:

1x1 Propozim – Vendimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, Nr. 01-020/04-0073356/24, dt. 11.11.2024.

T'i dërgohet:

1x1 Kryetarit të Komunës
1x1 Zyrës Ligjore
1x1 Zyrës për Informim
1x1 Drejtorisë për Shëndetësi
1x1 Anëtarëve të Grupit Punues
1x1 Arkivit